



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA - PRESEDNIK

Nr. 61/2018

Presidenti i Republikës së Kosovës,

në pajtim me nenin 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 6 të Ligjit Nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 47, 25 janar 2009), si dhe në pajtim me nenin 3 (4), të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për Strukturën Organizative të Presidencës (08.09.2016), dhe Vendimin Nr. 51/2017 të Presidentit për emërimin e Ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Nr. Protokolli 892-01.11.2017), nxjerr:

V E N D I M

**PËR EMËRIMIN E EKIPIT PËRGATITOR PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR
TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN¹**

1. Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Në tekstin e mëtejshëm: Ekipi) përbëhet prej gjithsej 9 (nëntë) anëtarëve/eve me këtë përbërje:

- 1) Ardian Arifaj - Presidenca – Kryesues;
- 2) Besim M. Kajtazi - Presidenca – Anëtar;
- 3) Nora Ahmetaj - Shoqëria civile – Anëtare;
- 4) Rron Gjinovci - Shoqëria civile – Anëtar;
- 5) Jovana Radosavljević - Shoqëria civile – Anëtare;
- 6) Kushtrim Koliqi - Shoqëria civile – Anëtar;
- 7) Abdullah Ferizi- Shoqëria civile – Anëtar;
- 8) Arben Loshi – Drejtorja për Hulumtim, Bibliotekë dhe Arkivë - Kuvend- Anëtar;
- 9) Baki Svirca -Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës -Qeveri – Anëtar.

¹ Pika 5 e këtij Vendimi është ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Presidentit nr. 44/2019 (01.03.2019), ndërsa Pika 13 e këtij Vendimi është ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Presidentit nr. 256/2019 (15.10.2019) dhe këto ndryshime janë të përfshira në këtë Vendim.

2. Pjesëmarrja e secilit anëtar nuk mund të delegohet.
3. Ekipi ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 3.1. Harton aktin përkatës normativ për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (Komisioni);
 - 3.2. Harton dokumentet relevante që rregullojnë funksionimin e brendshëm, vendimmarrjen dhe administrimin e Komisionit;
 - 3.3. Përgatit propozim organogramin e Komisionit;
 - 3.4. Propozon kriteret dhe procesin që duhet ndjekur për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit dhe personelit që do të ndihmojë Komisionin;
 - 3.5. Përpilon planin për angazhimin e personelit që do të ndihmojë Komisionin;
 - 3.6. Përpilon planin për trajnimin e anëtarëve të Komisionit dhe personelit që do të ndihmojë Komisionin;
 - 3.7. Identifikon kërcënimet dhe rreziqet për pjesëmarrësit në Komision, se si duhet lehtësuar ato, dhe cilat burime do të vihen në dispozicion;
 - 3.8. Propozon infrastrukturën e nevojshme logjistike për funksionalizimin e Komisionit;
 - 3.9. Përgatit planin e buxhetit si dhe planifikimin për sigurimin e fondeve nga burimet vendore dhe ndërkombëtare;
 - 3.10. Përpilon planin për fushatë informimi për Komisionin, dhe
 - 3.11. Çështjet tjera që ekipi i konsideron të nevojshme për funksionalizimin e Komisionit.
4. Ekipi mund të ketë së paku dy ekspert këshilltar, të cilët do të ofrojnë shërbime të konsulencës dhe ekspertizës dhe nuk do të kenë të drejtë vote.
5. Ekipi nxjerrë rregulloren e punës dhe cakton një plan-pune (duke përfshirë edhe orarin e takimeve të Ekipit) dhe afatet që duhet respektuar për përfundimin e përgjegjësisë të përcaktuara në këtë vendim.
6. Gjatë realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë, Ekipi organizon konsultimet e nevojshme publike me të gjithë hisedarët relevantë, që përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - 6.1. personat fizikë dhe juridik, që janë marrë me drejtësinë tranzicionale në Kosovë dhe jashtë Kosove, me synim që të përfshijë në punën e Komisionit rezultatet pozitive që janë arritur tani apo/dhe të mësojë nga përballja me sfidat që kanë hasur;
 - 6.2. takime me hisedarët për tu/të informuar për Komisionin;
 - 6.3. bashkëpunimin me nismat e ngjashme rajonale;
 - 6.4. rishqyrtimin dhe propozimin, në konsultim me palët e interesuara, se si Komisioni do të bashkëveprojë me proceset e tjera të drejtësisë tranzicionale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në proceset gjyqësore.
7. Sipas nevojave të punës dhe për realizimin e përgjegjësisë të përcaktuara me këtë Vendim, Ekipi mund të angazhojë konsulencë të jashtme dhe të brendshme si dhe përfaqësues të institucioneve tjera dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për të kontribuar në punën e Ekipit.
8. Ekipi, sipas nevojës, mund të themelojë Grupet Punuese që të merren me çështje të veçanta e që kërkojnë trajtim dhe ekspertizë të veçantë.

9. Sekretari i Zyrës së Presidentit:
- 9.1. cakton Sekretarinë që do të ndihmojë dhe përkrahë Ekipin në arritjen e përgjegjësive dhe mbështetjen administrative të Ekipit;
 - 9.2. përkujdeset që të sigurojë buxhetin e nevojshëm për mbështetjen e Ekipit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të tij;
 - 9.3. nxjerrë vendim për pagesën e anëtarëve të Ekipit;
 - 9.4. siguron buxhetin e nevojshëm për angazhimin e konsulencës së jashtme, në harmoni me nevojat e Ekipit, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 9.5. përkujdeset dhe bashkëpunon me Kryesuesin e Ekipit që të sigurojë buxhetin e nevojshëm për punën, angazhimin, pjesëmartjen në takime, si dhe funksionimin e përgjithshëm të Ekipit dhe të Sekretarisë.
10. Sekretaria i përgjigjet direkt kryesuesit të Ekipit dhe kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Ekipi, në pajtim me Rregulloren e punës së Ekipit.
11. Anëtarët e Ekipit janë të pavarur në punën e tyre dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin e Kosovës.
12. Kryesuesi i Ekipit në baza mujore do t'i raportojë Presidentit për ecurinë e punës së Ekipit.
13. Ekipi është i obliguar që më së largu, deri më datën 31 tetor 2020, të përfundojë punët e përcaktuar në këtë vendim.
14. Të gjeturat do t'i ofrohen Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe bëhen publike nga Ekipi për të siguruar transparencë të plotë.
15. Vendimi hyn në fuqi nga data 01 maj 2018.

Hashim THAÇI

President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 27 prill 2018

Vendimi t'i dërgohet:

- Sekretarit të Zyrës së Presidentit;
- Anëtarëve të Ekipit;
- a/a.